

## RELACION

### PËR

## PROJEKTLIGJIN

### “PËR ARBITRAZHIN NDËRKOMBËTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Hartimi i këtij projektligji vjen përveç si një domosdoshmëri për përcaktimin e rregullave për arbitrazhin Ndërkombëtar, edhe në referim të përcaktimeve të bëra në nenin 439 të Kodit të Procedurës Civile edhe në plotësimin e kuadrit ligjor që rregullon format e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, pas miratimit të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

Ndërmjetësimi dhe arbitrazhi janë dy institute të së drejtës publike, dhe si forma alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mënyrë paqësore, gjejnë një rregullim të gjërë në legjislacionin shqiptar. Arbitrazhi si një proces i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes, i ngjashëm me procesin gjyqësor, por edhe i ndryshëm nga ai, pasi vepron brenda kuadrit ligjor dhe jashtë sistemit gjyqësor.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është parashikuar ndërmarrja e nismës nga Ministria e Drejtësisë për hartimin dhe miratimin e projektligjit për Arbitrazhin ndërkombëtar, me qëllim nxitjen e zhvillimit të formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve jashtë hallkave të sistemit gjyqësor, për të kontribuar në këtë mënyrë në ushtrimin e të drejtës për të patur një gjykim të drejtë të palëve, brenda afateve të arsyeshme kohore dhe duke ndikuar në uljen e volumit të punës nëpër gjykata, duke ulur dhe kostot e zgjidhjes së tyre.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji rregullon arbitrazhin ndërkombëtar, bazuar në modelin e ligjit për arbitrazhin ndërkombëtar të UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare).

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar një sërë aktesh ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit, duke përfituar të drejta dhe duke marrë përsipër detyrime. Aktet ndërkombëtare në të cilat shteti shqiptar është palë janë: 1. *Konventa “Për pajtim dhe arbitrazh e OSBE-së”*, e aderuar me ligjin nr. 8012/1995, e cila parashikon rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Pajtitimit dhe Arbitrazhit, me synimin e angazhimit të shteteve anëtare për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre me mjete paqësore; 2. *Konventa Evropiane e Arbitrazhit*, aderuar me

ligjin nr. 8687/2000, e cila parashikon rregulla për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshjes e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme, si dhe rregulla mbi procedurën dhe vendimet e arbitrazhit; 3. Konventa "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", aderuar me ligjin nr. 8688/2000, e cila parashikon rregulla mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë dhënë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizikë ose juridikë. Gjithashtu, dispozitat e kësaj Konvente zbatohen edhe për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet ekzekutimi i tyre, parashikimet e të cilave janë mbajtur parasysh në hartimin e këtij projektligji.

Nga konsultimi i praktikës gjyqësore, gjatë viteve të fundit njihen shumë pak raste të aplikimit të arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pasurore. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së besimit nga ana e palëve në konflikt për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet në një "gjykatë private" dhe mbase edhe të mungesës së një rregullimi ligjor më vete dhe më të detajuar për arbitrazhin tregtar. Me qëllim plotësimin e këtij boshllëku dhe nxitjen e aplikimit të gjërë të formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën tregtare, në mbështetje të bashkëpunimit ndërkombëtar, të ofruar nga ekspertët të UNCITRAL (Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare), Ministria e Drejtësisë ndërmori nismën për hartimin e këtij projektligji.

Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parime për rregullimin e arbitrazhit ndërkombëtar, duke krijuar një bazë ligjore të nevojshme dhe të domosdoshme, për ushtrimin e profesionit të arbitrit, rregullat e procedurat e zhvillimit të procedimeve të arbitrazhit, të cilat janë të përcaktuara sipas vullnetit të palëve dhe mjetet juridike me anë të cilit shpreh qëndrimin e saj gjykata e arbitrazhit (vendime të ndërmjetme apo vendime përfundimtare) dhe kriteret e pamundësisë së njohjes apo ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit.

#### **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

#### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në projektligj trajtohen përkufizimet përkatëse për arbitrazhin ndërkombëtar, të termave të përdorur dhe rregullat e interpretimit, njoftimet e komunikimeve me shkrim, marrëveshjen e arbitrazhit.

Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim. Marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet e shkruar nëse përmbajtja e saj është e dokumentuar dhe e nënshkruar nga palët, ose është e dokumentuar nga këmbimi i letrave, teleksit, apo mënyrave të tjera të komunikimit të cilat mund të dokumentohen.

Referimi në një kontratë i një dokumenti që përmban një klauzolë arbitrazhi përbën një marrëveshje arbitrazhi me kusht që kontrata të jetë më shkrim dhe referimi të jetë i tillë që t'a bëjë atë klauzolë pjesë të kontratës.

Në përmbajtjen e tij (Kreu III), projektligji trajton përbërjen e gjykatës së arbitrazhit dhe konkretisht numrin e arbitrave, të cilin palët e vendosin lirisht dhe në mungesë të një vendimi në

marrëveshjen e arbitrazhit, numri i arbitrave të jetë tre. Më tej projektligji, përcakton kushtet për emërimin e arbitrave, sipas rregullave procedurale të një komisioni *ad hoc* të zgjedhur nga palët ose sipas rregullave të vendosura nga një Institucioni i Përhershëm Arbitrazhi.

Nëse palët nuk bien dakord për zgjedhjen e arbitrit, në rastet kur gjykimi i mosmarrëveshjes me arbitrazh është parashikuar në marrëveshjen midis palëve që të kryhet me një arbitër, ky i fundit do të caktohet, me kërkesë të njëres prej palëve, nga Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit nëse mosmarrëveshja do të gjykohet në kuadër të një institucioni të tillë, ose nga Gjykata e Tiranës nëse çështja nuk do të gjykohet në kuadër të një Institucioni të Përhershëm Arbitrazhi, ose kur Institucioni nuk ka rregulla të parashikuara për emërimin e arbitrave.

Në rastin kur një palë nuk vepron sipas një procedure të rënë dakord, ose kur dy arbitrat nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje sipas procedurës së rënë dakord apo edhe kur një palë e tretë (qoftë kjo edhe një institucion) nuk përmbush funksionin që i është caktuar, secila nga palët mund t'i kërkojë gjykatës së arbitrazhit ose Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit të marrë masat e nevojshme për emërimin e arbitrave, përveç rasteve kur marrëveshja mbi procedurat e emërimit parashikon mjete të tjera për të garantuar emërimin. Vendimi i dhënë nga gjykata e arbitrazhit ose Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit nuk i nënshtrohet procedurave të ankimit.

Emërimi i një arbitri mund të kundërshtohet nëse personi të cilit i propozohet emërimi si arbitër nuk ka shprehur me shkrim pohimin:

- kur ka rrethana të cilat mund të ngjallin dyshime për paanësinë dhe pavarësinë e tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjes si dhe
- kur pala që e ka emëruar ose ka marrë pjesë në emërimin e tij e ka përjashtuar për shkaqe që bëhen të njohura pas emërimit.

Palët janë të lira të përcaktojnë procedurën për kundërshtimin e emërimit të një arbitri dhe në mungesë të saj, pala që kundërshton duhet t'ia bëjë të ditur gjykatës së arbitrazhit me anë të një deklaratë me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni e përbërjes së gjykatës së arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit merr vendim lidhur me kërkesën përveçse kur arbitri për të cilin është paraqitur kundërshtimi tërhiqet.

Kur kërkesa për kundërshtim të përbërjes së gjykatës së arbitrazhit rrëzohet, pala që ka paraqitur kërkesën për kundërshtim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit të vendimit që rrëzon kërkesën e saj për kundërshtimin, mund të kërkojë nga gjykata e arbitrazhit ose Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit i parashikuar në nenin 12 të projektligjit që të vendosë në lidhje me këtë kërkesë. Kundër vendimit të gjykatës së arbitrazhit apo Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit nuk lejohet ankim.

Mandati i arbitrit do të përfundojë kur:

- Është i paaftë të përmbushë funksionet e tij;
- ose për arsye të ndryshme nuk i përmbush detyrat e tij në afatin e caktuar,
- kur ai tërhiqet nga kjo detyrë;
- ose kur palët merren vesh për përfundimin e kësaj detyre

Në rastin kur mandati i arbitrit përfundon për ndonjë nga arsyet e parashikuara në projektligj, ose për shkak të tërheqjes së tij nga detyra ose për shkak të revokimit të mandatit të tij, ose për çdo arsye tjetër, atëherë një arbitër zëvendësues do të caktohet sipas rregullave të zbatueshme për emërimin e arbitrit.

Në Kreun IV, trajtohen çështje të juridiksionit të arbitrave, kompetencat e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur mbi juridiksionin e saj, si dhe çdo kundërshtim apo pavlefshmëri të marrëveshjes së arbitrazhit. Në rastin kur në një kontratë ka një klauzolë arbitrazhi, klauzola do

të trajtohet e pavarur nga kushtet e tjera të kontratës. Vendimi i dhënë nga gjykata për pavlefshmërinë e kontratës nuk sjell pavlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit.

Kërkesë padia për shpalljen e mungesës së juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit ngrihet sapo mungesa e pretenduar e juridiksionit konstatohet gjatë procesit të gjykimit të arbitrazhit. Kërkesë padia për mungesën e juridiksioni të gjykatës së arbitrazhit ngrihet jo më vonë se data e paraqitjes së prapësimeve me shkrim të palës së paditur. Kërkesa e paraqitur pranë kësaj gjykate nuk pezullon vazhdimin e procedurave të gjykimit të arbitrazhit dhe marrjen e vendimit. Kundër vendimit të gjykatës së arbitrazhit ose Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit nuk lejohet ankimi.

Gjykata e arbitrazhit me kërkesën e një prej palëve mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme për sigurimin e objektit të padisë, të cilat mund të merren në çdo kohë para dhënies së vendimit përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Masat e përkohshme mund të përfshijnë ruajtjen e *status quo* në pritje të vendimit, marrjen e masave të cilat do të parandalonin shkaktimin e ndonjë dëmi të mundshëm për kërkuesin, sigurimin e ruajtjes së aseteve të cila mund të jenë objekt i një vendimi të ardhshëm, si edhe ruajtjen e provave dhe materialeve që mund të jenë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Barra për të provuar para gjykatës së arbitrazhit të lejojë marrjen e masave të përkohshme bie mbi palën kërkuese, e cila duhet të provojë se dëmi i shkaktuar nuk mund të riparohet me vendim dëmshpërblimi nëse masa nuk urdhërohet dhe dëmi i shkaktuar tejkalon dëmin që mund t'i rezultojë palës së paditur, si dhe ka një mundësi të arsyeshme që pala kërkuese do të ketë sukses për themelin e padisë. Masat e kërkuara do të jepen në masën që gjykata e arbitrazhit i konsideron të përshtatshme. Marrja e masave nga gjykata e arbitrazhit i bën ato njësoj detyruese si një masë e marrë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Në rastin kur palët nuk zbatojnë masat e përkohshme të dhëna nga gjykata e arbitrazhit, atëherë gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një vendim të ndërmjetëm, nëse çmon se njoftimi paraprak i kërkesës për masën e përkohshme ndaj palës kundër të cilës drejtohet, rrezikon të pengojë qëllimin e masës. Kjo gjykatë mund t'i kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zbatimin e kësaj mase.

Pasi është marrë vendimi i ndërmjetëm për një masë të përkohshme, gjykata e arbitrazhit njofton palët në lidhje vendimin e ndërmjetëm për masën e përkohshme, dhe të gjitha komunikimet e tjera duke përfshirë regjistrimin e përmbajtjes të ndonjë komunikimi verbal ndërmjet palëve dhe gjykatës së arbitrazhit. Pala ndaj të cilës është dhënë një masë e përkohshme, i jep mundësi të paraqesë çështjen e saj sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjykata vendos ndaj çdo kundërshtimi të masës së përkohshme. Masa e përkohshme përfundon pas njëzet ditësh nga data e lëshimit të tij prej gjykatës së arbitrazhit. Vlefshmëria e masës së përkohshme përfundon pas njëzet ditësh nga data e lëshimit të saj prej gjykatës së arbitrazhit. Megjithatë, gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një masë të përkohshme që miraton ose ndryshon, vendimin e ndërmjetëm, pasi pala kundër të cilës drejtohet urdhri paraprak, të ketë dhënë njoftim dhe të ketë mundësi për të paraqitur kërkesë padinë e saj. Urdhri i përkohshëm do të jetë detyrues për palët por nuk do t'i nënshtrohet zbatimit nga një gjykatë.

Gjykata e arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose përfundojë një masë paraprake ose një urdhër të përkohshëm që ka lëshuar, pas kërkesës së një pale ose në rrethana të jashtëzakonshme dhe pas njoftimit paraprak të palëve.

Pala që kërkon marrjen e masës së përkohshme mund të urdhërohet nga gjykata e arbitrazhit të ofrojë garancinë e duhur në lidhje me masën. Gjykata për raste të tilla mund të kërkojë marrjen e një urdhri të përkohshëm.

Në rastin kur ka një ndryshim material të rrethanave mbi bazën e të cilës është kërkuar apo lëshuar urdhri, palës i lind detyrimi të japë njoftim në lidhje me këtë ndryshim. Ky detyrim do të

vazhdojë derisa pala kundër të cilës është kërkuar urdhri, të ketë mundësi për të paraqitur kërkesë padinë e saj në themel. Pala që kërkon një masë të sigurimit të padisë ose vendim të ndërmjetëm është përgjegjëse për kostot dhe dëmet e shkaktuara nga masa ose vendimi për çdo palë. Në rastin kur gjykata konstaton se masa ose vendimi i ndërmjetëm nuk duhet të ishin lëshuar, gjykata mund të vendosë të kompensojë këto kosto dhe dëme në çdo kohë gjatë procedimeve.

Masa e përkohshme e lëshuar nga një gjykatë arbitrazhi njihet si detyruese dhe nëse nuk parashikohet ndryshe nga gjykata e arbitrazhit, zbatohet pas kërkesës për gjykatën kompetente, pavarësisht nga vendi në të cilin është lëshuar. Pala që kërkon ose ka siguruar njohjen ose zbatimin e një mase të përkohshme, do të informojë menjëherë gjykatën për çdo përfundim, pezullim ose ndryshim të asaj mase. Gjykata e Shtetit ku kërkohet njohja ose zbatimi, nëse e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë palën kërkuese të ofrojë garancinë e duhur, nëse gjykata e arbitrazhit nuk është shprehur në lidhje me garancinë ose kur ky vendim është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta.

Në Kreun V parashikohet drejtimi i procedurave të arbitrazhit, trajtimi i njëjtë i palëve, përcaktimi i rregullave proceduriale për t'u zbatuar gjatë procedurës së arbitrazhit për të cilat palët janë të lira për rënien dakord të procedurës së ndjekur në zhvillimin e procesit të gjykimit, vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Kompetenca e dhënë gjykatës së arbitrazhit përfshin kompetencën për të përcaktuar pranueshmërinë, rëndësinë dhe barrën e provave.

Në rastin kur nuk ka një marrëveshje midis palëve për procesin e arbitrazhit në bazë të dispozitave të këtij projektligji, gjykata e arbitrazhit mund të zhvillojë arbitrazhin në mënyrën që e çmon të përshtatshme, si dhe të vendosë për vendin e zhvillimit të arbitrazhit. Në rastin kur nuk bihet dakord ndryshe nga palët, gjykata mund të mblihet në çdo vend që e çmon të përshtatshëm.

Nëse në marrëveshjen e lidhur midis palëve nuk parashikohet ndryshe, procesi i gjykimit të arbitrazhit në lidhje me një mosmarrëveshje të caktuar, fillon në datën në të cilën kërkesa për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje para gjykatës së arbitrazhit, i është njoftuar palës së paditur. Palët janë të lira të përcaktojnë gjuhën/gjuhët e marrëveshjes, në rastin kur nuk është përcaktuar nga palët, vendos gjykata e arbitrazhit. Gjuha e përdorur për marrëveshjen do të përdoret edhe për çdo akt procedural të paraqitur nga palët; seancat e gjykimeve të arbitrazhit; dhe vendimet apo komunikimet e tjera të kryera nga gjykata e arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë që çdo provë dokumentuese të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën ose gjuhët e caktuara me marrëveshje midis palëve ose të përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit.

Paditësi do të deklarojë faktet që mbështesin kërkesën e tij, pretendimet dhe kompensimin ose mjetin ligjor të kërkuar brenda periudhës kohore të rënë dakord nga palët ose të përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit. Palët mund të paraqesin me deklaratat e tyre të gjitha dokumentet që çmojnë të nevojshme ose mund të shtojnë një referencë ndaj dokumenteve ose provave të tjera që paraqesin. Çdo palë mund të ndryshojë ose plotësojë padinë ose mbrojtjen e saj gjatë procesit të gjykimit të arbitrazhit, përveç rasteve kur gjykata e arbitrazhit e çmon të papërshtatshme lejimin e këtij ndryshimi, duke marrë parasysh vonesën që i shkakton procesit kryerja e tij.

Në rast të mos arritjes së një marrëveshjeje midis palëve, gjykata e arbitrazhit vendos nëse duhet të zhvillojë seanca për paraqitjen verbale të provave apo për debat gjyqësor, ose nëse procesi do të zhvillohet mbi bazën e dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara.

Nëse një palë nuk mund të paraqitet në një seancë ose nuk mund të përgatisë prova dokumentuese mbështetëse; gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjykimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura pranë saj.

Nëse nuk është rënë dakord nga palët, gjykata e arbitrazhit mund të caktojë një ose më shumë ekspertë që do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit. Gjykata mund t'i kërkojë një pale

t'i japë ekspertit çdo informacion përkatës ose të përgatisë, ose garantojë akses në dokumente, mallra ose pasuri të tjera për inspektim nga ana e tij. Ekspertit i jepet e drejta të marrë pjesë në një seancë ku palët kanë mundësi t'i bëjnë atij pyetje dhe të paraqesin dëshmitarët ekspertë për të dëshmuar mbi çështjet në fjalë. Pas miratimit të marrjes së provave, gjykata e arbitrazhit ose një palë mund të kërkojë ndihmë nga një gjykatë kompetente për marrjen e provave, sipas rregullave të saj për marrjen e provave.

Në Kreun VI parashikohet marrja e vendimit dhe përfundimi i procedurave, rregullat e zbatueshme për zgjidhjen e thelbit të mosmarrëveshjes. Për arbitrazhin ndërkombëtar, gjykata e arbitrazhit do të vendosë për mosmarrëveshjen në përputhje me rregullat e zgjedhura nga palët. Çdo përcaktim i ligjit ose sistemit ligjor të një Shteti të caktuar interpretohet, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, sikur i referohet drejtpërdrejt ligjit material të atij Shteti dhe jo rregullave të tij për të drejtën ndërkombëtare private. Në mungesë të marrjes së një vendimi nga palët, gjykata e arbitrazhit do të zbatojë ligjin e përcaktuar nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare private që ajo vlerëson si të zbatueshëm.

Gjykata e arbitrazhit do të vendosë *ex aequo et bono* ose si *amiable compositeur*<sup>1</sup>, vetëm nëse palët kanë lejuar këtë gjë shprehimisht. Në të gjitha rastet, gjykata e arbitrazhit do të vendosë në përputhje me kushtet e kontratës dhe do të marrë në konsideratë rregullat zakonore të tregtisë të zbatueshme për transaksionin. Në procedurat e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i gjykatës së arbitrazhit do të merret nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, me shumicë të të gjithë anëtarëve të tij. Megjithatë, çështjet e procedurës mund të vendosen nga një arbitër kryesues, nëse kjo autorizohet nga palët ose të gjithë anëtarët e gjykatës së arbitrazhit.

Në rastin kur gjatë procedurave të arbitrazhit palët zgjidhin mosmarrëveshjen, gjykata e arbitrazhit do të përfundojë procesin dhe, nëse kërkohet nga palët dhe nuk kundërshtohet nga gjykata e arbitrazhit, do të regjistrojë marrëveshjen në formën e një vendimi arbitrazhi në bazë të kushteve të rëna dakord. Nëse vendimi është në bazë të kushteve të rëna dakord, vendimi ka të njëjtën fuqi si çdo vendim tjetër i marrë mbi themelin e çështjes. Vendimi jepet me shkrim dhe nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat. Vendimi përcakton arsyet mbi të cilat bazohet, nëse palët nuk kanë rënë dakord mbi mosdhënien e arsyeve ose nëse vendimi është një vendim arbitrazhi në bazë të kushteve të rëna dakord. Vendimi ka të përcaktuar datën dhe vendin e arbitrazhit dhe duhet të jetë i nënshkruar nga arbitrat dhe i dorëzohet secilës palë.

Procedurat e arbitrazhit përfundojnë në bazë të vendimit të formës së prerë ose një vendimi të ndërmjetëm të gjykatës së arbitrazhit. Vendimi i ndërmjetëm merret kur paditësi ka tërhequr padinë dhe gjykata e arbitrazhit pranon interesin e ligjshëm të tij në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare të mosmarrëveshjes, palët bien dakord për përfundimin e procedurave dhe kur gjykata e arbitrazhit konstaton se vazhdimi i procedurave është bërë i panevojshëm ose i pamundur. Mandati i gjykatës së arbitrazhit përfundon me përfundimin e procedurave të arbitrazhit.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dhënia e vendimit, palët me njoftim bërë njëra-tjetrës mund t'i kërkojnë gjykatës së arbitrazhit të korrigjojë në vendimin e arbitrazhit gabimet në llogaritje, gabimet ortografike ose tipografike ose çdo gabim të një natyre të ngjashme, njëkohësisht vetë gjykata mund të korrigjojë çdo gabim me iniciativë të vet. Nëse palët bien dakord, njëra palë mund të kërkojë interpretim specifik lidhur me vendimin. Nëse gjykata e arbitrazhit çmon se kërkesa është e bazuar, ajo bën korrigjimin ose jep interpretimin brenda tridhjetë ditëve nga marrja e kërkesës. Interpretimi bëhet pjesë e vendimit përfundimtar të arbitrazhit.

---

<sup>1</sup> Parim ligjor i cili i lejon arbitrave të çështjes të marrin një vendim sipas principeve ligjore të cilat ata mendojnë se janë të drejta., pa qenë të të limituar t'i referohen ndonjë legjislacioni kombëtar.

Gjykata gjithashtu, mund të marrë një vendim shtesë, pas marrjes së kërkesës nga palët të cilat i komunikojnë njëra-tjetrës brenda 30 (tridhjetë) ditëve lidhur me pretendimet e paraqitura në procesin e arbitrazhit por që nuk janë përfshirë në vendim. Gjykata shprehet me vendim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve apo më shumë kur e shikon të nevojshme duke ruajtur formën dhe përmbajtjen e vendimit.

Projektligji parashikon në Kreun VII rregullat për ankimin kundër vendimit të arbitrazhit, duke vijuar me kërkesën për anulimin si ankim ekskluziv kundër vendimit të arbitrazhit. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të ankimohej në Gjykatën e Apelit të Tiranës, pas paraqitjes së një kërkesë për anulim. Gjykata e Apelit Tiranë, para se të shprehet do të marrë në konsideratë *nëse pala që bën kërkesën provon se ka qenë në kushtet e një pavlefshmërie të parashikuar në projektligj, ose kur marrëveshja nuk është e vlefshme sipas ligjit të cilit i nënshtrohen palët, ose në mungesë të kushteve të parashikuara në legjislacionin shqiptar, ose kur nuk është bërë njoftimi i duhur për caktimin e një arbitri ose për fillimin e procedurës së arbitrazhit apo kur për ndonjë arsye tjetër nuk ka patur mundësi të paraqiste pretendimet e saj në lidhje me mosmarrëveshjen; ose vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar ose që nuk hyn brenda kushteve për referimin në arbitrazh, ose përmban vendime mbi çështje jashtë objektit të referimit në arbitrazh, përbërja e gjykatës së arbitrazhit apo procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjen e palëve. Gjithashtu, Gjykata e Apelit do të shprehet me vendim kur konstaton se subjekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet me arbitrazh sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë; ose vendimi është në kundërshtim me politikën publike të Republikës së Shqipërisë. Ankimi në Apel duhet të paraqitet brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi është shpallur.*

Në Kreun VIII të pjesës së dytë parashikohet njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit, arsyet për refuzimin e njohjes ose zbatimit të vendimeve, si dhe dispozitat përfundimtare. Vendimi i arbitrazhit është i detyrueshëm për zbatim, pavarësisht vendit në të cilin është marrë. Pala e interesuar për zbatimin e vendimit, duhet të paraqesë kopjen origjinale apo të njehsuar me origjinalin të vendimit të arbitrazhit, dhe marrëveshjes së arbitrazhit. Nëse vendimi apo marrëveshja janë në gjuhë të huaj, pala duhet të paraqesë një përkthim të vërtetuar të tyre në gjuhën shqipe.

## **VI. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji do të përcillet për mendim pranë ministrive të linjës dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë për konsultim publik.

## **VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI**

**YLLI MANJANI**